Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin e Warmia dhe Mazuri në Olsztyn, Poloni në kuadër të programit Erasmus +

Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë në Universitetin e Warmia dhe Mazuri në Olsztyn, Poloni, gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2026-2027, në periudhën Shkurt - Qershor 2027.

Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë studentët e UMT të cilët gjatë vitit akademik 2026-2027 do të jenë në vitin e dytë dhe të tretë, të ciklit bachelor dhe në vitin e parë të ciklit Master në:

- Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës

Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.
Ju mund të gjeni listën e lëndëve që zhvillohen në anglisht në universitetin pritës për semestrin e parë duke klikuar link: https://uwm.edu.pl/en/erasmus/course-catalogue/faculty-geoengineering

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët;

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- Kopje e pasaportës
- Vërtetim dhe Listë notash të ciklit aktual të studimit;
- Learning Agreement mund ta sharkoni në linkun: Outgoing Students Online Documents

** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ''Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të jepni provim lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana.

Dokumenti ''Learning Agreement'' tek seksioni ''Commitment'' firmoset nga aplikanti dhe më pas në seksionin ''sending university'' firmoset nga Përgjegjësi i Programit në UMT.

Aplikimi duhet të kryhet online, përmes linkut të mëposhtëm:
https://forms.cloud.microsoft/e/JW6QidGxMb
Afati për aplikim: **2 Nëntor, 2026.**

Për më shumë informacion mbi bursat apo asistencë mund të na kontaktoni në adresën: iro-projets@umt.edu.al

#OnceErasmusAlwaysErasmus